

Dhoksologji në ditën e Pavarësisë



Sot, me 28 Nëntor, festa kombëtare me rastin e 106-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, në kishat tona u krye “Dhoksologjia e flamurit”.

Në të thuhet:

“O Zot, që bekon dhe shenjtëron, Ti bekoje flamurin tonë, dhe shpëtoje shtetin tonë dhe popullin tonë nga çdo rrezik dhe vështirësi dhe drejtoje në udhën e dritës, të lirisë dhe të përparimit nën hijen Tënde dhe vlerësona ne të pavyerit të kremtojmë këtë ditë të lavdëruar me nder, shëndet edhe ditë të gjata këtu dhe kudo.

Se ti je Perëndi mëshirëplote dhe njeridashës, dhe ty të drejtojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë, dhe në jetët e jetëve”.